



BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Raporti i realizimit të planit vjetor për 2023

Janar, 2024

Raporti i realizimit të Planit vjetor të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit për vitin 2023 është hartuar në bazë të Metodologjisë për planifikim strategjik dhe përgatitje të programit vjetor të punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 124/08 dhe 58/18) dhe Udhëzuesit për mënyrën e veprimit të ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore në procesin e hartimit të planit strategjik dhe planit vjetor të punës ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 131/18).

Me Planin vjetor të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit 2023, janë të operacionalizuara masat dhe aktivitetet e vitit të parë në përmbajtje të Planit Strategjik të Byrosë për vitin 2023-2025, të cilët janë në funksion të realizimit të prioriteteve dhe qëllimeve strategjike të Byrosë dhe prioriteteve dhe qëllimet strategjike të MASH-it dhe të Qeverisë së RMV-së. Rrjedhimisht me të, raporti përmban një pasqyrë të rezultateve të arritura të Byrosë nga zbatimi i programit, nënprogramet, masat dhe aktivitetet e punëve aktuale si dhe masat/aktivitetet e planifikuara por të përcaktuara me arsyetim të mosrealizimit të tyre.

Me qëllim të rritjes së llogaridhënies dhe transparencës në funksionimin e Byrosë si dhe raportimit të rezultateve të arritura, ky raport ofron një pasqyrë konkrete të zbatimit të programit dhe nënprogrameve nga Planin vjetor i punës për vitin 2023 të institucionit tonë.

1. PROGRAME

Plani vjetor i punës së Byrosë së Zhvillimit të Arsimit për vitin 2023 është hartuar me qëllim të arritjes së prioriteteve dhe qëllimeve strategjike të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, rrjedhimisht edhe me prioritetet dhe qëllimet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023 (Vendim për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2023, "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 122, datë 30.05.2022), dhe në pajtim me Planin Strategjik të Byrosë për vitin 2023-2025 (nr.01-348/2 më 08.02.2023) dhe Strategjia Gjithëpërfshirëse për Zhvillimin e Arsimit 2018-2025.

- Prioriteti strategjik i Qeverisë së RMV-së, që përmban Vendimi për prioritetet strategjike për vitin 2023 "rritja e cilësisë së arsimit me qasje për të gjithë, sipas kërkesës së tregut të punës, zhvillimi dhe promovimi i kulturës dhe sportit".
- Qëllimet parësore që përmban Vendimi për prioritetet strategjike për vitin 2023 "zhvillimi i arsimit cilësor me qasje për të gjithë, që do të krijojë kuadër të aftë për të përmbushur nevojat e tregut të punës, të edukuar për të respektuar të drejtat civile, tolerancë reciproke dhe zhvillim të multikulturalizmit dhe ndërkulturalizmit".
- Prioritetet strategjike të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit:
 - përparimi dhe zhvillimi i procesit edukativ-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
 - përforsimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe në karrierë të kuadrit edukativ-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
 - përparimi i procesit të monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve.
 - zgjidhja e marrëdhënieve pronësore-juridike të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

Qëllimet parësore të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit:

- të implementohen reformat në arsimin fillor sipas Konceptit për arsim fillor;
- të krijohen standarde arsimore kombëtare dhe programe mësimore si dhe plane mësimore të arsimit të mesëm;
- të implementohet Koncepti për arsimin gjithëpërfshirës;
- të përmirësohen kompetencat e kuadrit edukativ-arsimor;
- të sigurohet monitorimi i mësimdhënësve përmes vizitave profesionale dhe sigurimin e zhvillimit të tyre në karrierë.

Me Planin Strategjik të Byrosë për vitet 2023-2025 është planifikuar të realizohet 1 program me 7 nënprograme, të cilat i dedikohen përmirësimit të cilësisë së arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm.

Për programin dhe për secilin nga nënprogramet e parashikuara, të cilat kanë iniciuar masa, projekte dhe aktivitete, Plani Vjetor i Punës për vitin 2023, ka përcaktuar burimet e nevojshme dhe mjetet financiare për zbatim, si dhe rezultatet e pritura të realizimit përfundimtar.

PROGRAMI: ARSIM CILËSOR PARASHKOOLLOR, FILLOR DHE I MESËM

Nënprograme:

1. Standardet e arsimit parashkollor
2. Standardet, planet dhe programet mësimore të arsimit fillor
3. Standardet, planet dhe programet mësimore të arsimit të mesëm (gjimnaz, artistik, gjimnazi i sportit, akademia e sportit, arsimi i mesëm profesional, arsimi i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe gjimnazi matematikë-informatikë)
4. Hulumtime për avancimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm
5. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i kuadrit edukativ-arsimor të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm
6. Monitorimi dhe vetëevaluimi i të arriturave të shkollave
7. Dokumentacioni dhe evidenca pedagogjike, përmbajtjet digjitale dhe kurset online

2. REZULTATET E ARRITURA

2.1 Vlerësimi i rezultateve nga zbatimi i programit dhe nënprogrameve të Planit strategjik:

<p>Lidhshmëria me prioritetin strategjik dhe qëllimin e Qeverisë:</p>	<p>Prioriteti strategjik i Qeverisë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Rritja e cilësisë së arsimit me qasje për të gjithë, sipas kërkesës së tregut të punës, zhvillimi dhe promovimi i kulturës dhe sportit. <p>Qëllimet parësore të Qeverisë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Zhvillimi i arsimit cilësor me qasje për të gjithë, që do të krijojë kuadër të aftë për të përmbushur nevojat e tregut të punës, të edukuar për të respektuar të drejtat civile, tolerancë reciproke dhe zhvillim të multikulturalizmit dhe ndërkulturalizmit.
<p>Lidhshmëria me prioritetet dhe qëllimet e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit:</p>	<p>Prioritetet strategjike të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- përparimi dhe zhvillimi i procesit edukativ-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;- ngritja e zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe në karrierë të kuadrit edukativ-arsimor në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;- përparimi i procesit të monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve. <p>Qëllimet parësore të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- të implementohen reformat në arsimin fillor sipas Konceptit për arsim fillor;- të krijohen standarde arsimore kombëtare dhe programe mësimore si dhe plane mësimore të arsimit të mesëm;- të implementohet Koncepti për arsimin gjithëpërfshirës (inkluziv);

	<ul style="list-style-type: none"> - të përmirësohen kompetencat e kuadrit edukativ-arsimor; - të sigurohet monitorimi i mësimdhënësve përmes vizitave profesionale dhe sigurimin e zhvillimit të tyre në karrierë. 	
<p>Titulli i programit:</p> <p style="text-align: center;">ARSIM CILËSOR PARASHKOLLOR, FILLOR DHE I MESËM</p>	<p>Qëllimi i programit:</p> <p style="text-align: center;">PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË NJOHURIVE TË FËMIJËVE DHE NËNËSVE</p>	<p>Përgjegjës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore • Sektori për hulumtime në arsim • Sektori për zhvillimin profesional të kuadrit edukativ-arsimor dhe punë profesionale-këshilluese • Sektori për zhvillimin profesional të kuadrit edukativ-arsimor dhe punë profesionale-këshilluese

		<ul style="list-style-type: none"> • Sektori për veprimtari botuese
--	--	--

Titulli i nënprogramit 1: <p style="text-align: center;">Standardet e arsimit parashkollor</p>	Qëllimi i nënprogramit: <p>Përmirësimi i cilësisë në arsimin parashkollor</p>	Përgjegjës: <p>Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore</p>
--	---	---

MASAT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA

Masat/aktivitetet	Indikatorët e rezultateve me pikënisjen dhe rezultati i planifikuar në nivel vjetor	Vlerësimi i progresit në arritjen e rezultateve dhe qëllimeve të programit	Koment
<p>1. Realizimi i trajnimeve për kuadrin edukativ-arsimor në lidhje me procesin edukativ-arsimor sipas kërkesës së Qeverisë, MPPS-së, MASH-it dhe dinamikës së zbatimit të reformave në arsimin parashkollor.</p>	<p>Janë trajnuar 30 kandidatë për të dhënë provimin për marrjen e licencës për drejtorë kopshtesh:</p> <p>1 këshilltar nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit ka marrë certifikatën për master trajner të licencuar për aplikimin e mjetit MELQO në nënsistemin e edukimit dhe arsimit parashkollor;</p> <p>20 bashkëpunëtorë profesionalë nga kopshtet janë trajnuar për</p>	<p>Kandidatët e trajnuar marrin certifikatën e trajnimit të përfunduar si kusht për marrjen e licencës së drejtorit.</p> <p>Këshilltari i trajnuar do të zhvillojë trajnim për 20 bashkëpunëtorë profesionalë të kopshteve për aplikimin e mjetit MELQO në nënsistemin e edukimit dhe arsimit parashkollor.</p> <p>Bashkëpunëtorët profesional të trajnuar do të përdorin njohuritë e</p>	

	përdorimin e mjetit MELQO për matjen e cilësisë së mësimit dhe zhvillimit të hershëm të fëmijëve në nënsistemin e edukimit dhe arsimit parashkollor.	marra në zbatimin e hulumtimit kryesor për të matur cilësinë e mësimit dhe zhvillimit të hershëm të fëmijëve në kopshtet publike, nëpërmjet aplikimit të mjetit MELQO.	
2. Realizimi i hulumtimit kryesor për të matur cilësinë dhe mjedisin për mësim dhe zhvillim të hershëm - Aplikimi i instrumentit të plotë MELQO.	Në dhjetor të vitit 2023 filloi hulumtimi për matjen e cilësisë së mësimit dhe zhvillimit të hershëm të fëmijëve në kopshtet publike.	Rezultatet e fituara do të përdoren për të planifikuar masat dhe aktivitetet e ardhshme për përmirësimin e cilësisë brenda nënsistemit të arsimit parashkollor.	
MASAT DHE AKTIVITETET SHITESË TË REALIZUARA - TË PAPLANIFIKUARA NË PLANIN VJETOR 2023			
Masat/aktivitetet	Indikatorët e rezultateve me pikënisjen dhe rezultati i planifikuar në nivel vjetor	Vlerësimi i progresit në arritjen e rezultateve dhe qëllimeve të programit	Koment
1. Punëtori për edukatorët e kopshteve nga Shkupi me temë “Lodrat për fëmijë – shëndeti dhe siguria e fëmijëve”, sipas aktiviteteve të planifikuara të Byrosë së Zhvillim të Arsimit në Programin për mbrojtjen e konsumatorëve për vitin 2023.	Janë trajnuar 46 edukatorë nga kopshtet e qytetit të Shkupit.	Edukatorët e trajnuar u njohën me të drejtat e konsumatorëve, të cilat garantojnë me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit, si dhe procedurën për realizimin e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit, pra përdorimin e lodrave në procesin edukativo-arsimor, por edhe zgjedhjen e duhur të një lodre për fëmijë e cila nuk rrezikon sigurinë dhe shëndetin e fëmijëve.	
2. Realizimi i monitorimit në kopshtet publike.	Këshilltarët për edukimin dhe arsimin parashkollor në Byronë e Zhvillimit të Arsimit në bashkëpunim me Sektorin e mbrojtjes së fëmijëve në MPPS dhe fakultetet pedagogjike të shtetit	Të dhënat e marra do të përdoren për avancimin e Programit të mësimit dhe zhvillimit të hershëm, planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve edukative, rishikimin e të dhënave dhe dokumentacionit pedagogjik në kopshte, si dhe për planifikimin e	

	kryen monitorim në 30 kopshte në vend.	zhvillimit profesional të stafit arsimor në kopshtet e fëmijëve.	
MASAT DHE AKTIVITETET E PAREALIZUARA			
Masa/aktiviteti	Arsyetimi	Ndikimi	Rekomandime
Nuk ka			

Titulli i nënprogramit 2: Standardet, planet dhe programet mësimore të arsimit fillor		Qëllimi i nënprogramit: Përmirësimi i cilësisë në arsimin fillor	Përgjegjës: Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore
MASAT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA			
Masat/aktivitetet	Indikatorët e rezultateve me pikënisjen dhe rezultati i planifikuar në nivel vjetor	Vlerësimi i progresit në arritjen e rezultateve dhe qëllimeve të programit	Koment
1. Hartimi i programeve të reja mësimore bazuar në standardet kombëtare me rezultate mësimore për lëndët nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë në përputhje me planin mësimor për arsimin fillor nga Koncepti i arsimit fillor 2021.	- Janë hartuar programe mësimore për klasën e VI (gjashtë) nga lëndët mësimore: Gjuhë maqedonase, Gjuhë shqipe, Gjuhë turke, Gjuhë serbe, Gjuhë boshnjake, Gjuhë maqedonase për nxënësit e komuniteteve tjera, Matematikë, Gjuhë angleze, Shkenca natyrore, Histori dhe shoqëri, Arsim	Mësimi në klasat e III (të treta) dhe të VI (të gjashta) nga viti shkollor 2023/24 zhvillohet sipas programeve të reja duke u bazuar në standardet e reja për arritjet e nxënësve dhe konceptin e arsimit fillor. Materialet mësimore të përmbajtjeve sipas programeve për lëndët në klasën e	

	<p>teknik dhe informatikë, Arsim muzikor, Arsim figurativ, Arsim fizik dhe shëndetësor, Gjuhë frënge, Gjuhë gjermane, Gjuhë italiane, Gjuhë ruse, Gjuhë shqipe (lëndë zgjedhore);</p> <p>- Janë hartuar programe mësimore për klasën e VII (shtatë) nga lëndët mësimore: Gjuhë maqedonase, Gjuhë shqipe, Gjuhë turke, Gjuhë serbe, Gjuhë boshnjake, Gjuhë maqedonase për nxënësit e komuniteteve tjera, Matematikë, Gjuhë angleze, Shkenca natyrore, Histori dhe shoqëri, Arsim teknik dhe informatikë, Arsim muzikor, Arsim figurativ, Arsim fizik dhe shëndetësor, Gjuhë frënge, Gjuhë gjermane, Gjuhë italiane, Gjuhë ruse, Gjuhë shqipe (lëndë zgjedhore).</p>	<p>tretë dhe të gjashtë përdoren në mësimdhënie në vitin shkollor 2023/2024.</p> <p>Doracakët për mësimdhënësit me materialet mësimore të përmbajtjeve sipas programeve për lëndët Arsim muzikor, Arsim figurativ, Arsim fizik dhe shëndetësor si dhe Arsimit teknik dhe informatika në klasat e treta dhe të gjashta përdoren në mësimdhënie nga viti shkollor 2023/2024.</p> <p>Mësimi në klasën e VII (shtatë) nga viti shkollor 2024/25 do të zhvillohet sipas programeve të reja bazuar në standardet e reja për arritjet e nxënësve dhe konceptin e arsimit fillor.</p>	
<p>2. Përgatitja e planeve mësimore në përputhje me kërkesat e Qeverisë, MASH-it dhe dinamikës së zbatimit të reformave në arsimin fillor.</p>	<p>- Është miratuar plani i ri për arsimin fillor për vitin shkollor 2023/2024;</p> <p>- Është miratuar plani i ri për arsimin fillor për vitin shkollor 2024/2025;</p> <p>- Janë miratuar planet mësimore nga klasa e I deri të IX për nxënësit me dëmtim të shikimit, dëmtim të dëgjimit, pengesa në zhvillimin mendor (paaftësi intelektuale),</p>	<p>Mësimi zhvillohet sipas planit dhe programit të ri në klasat I, II, III, IV, V dhe VI.</p> <p>Mësimi do të zhvillohet sipas planit dhe programit të ri në klasat I, II, III, IV, V, VI dhe VII.</p> <p>Mësimi në vitin shkollor 2023/24 nga klasa e parë deri në të gjashtë zhvillohet sipas planit të ri mësimor në përputhje me konceptin e ri për nxënësit me dëmtim të shikimit,</p>	

	<p>multihandikap dhe autizëm në shkollat fillore me qendër resurse dhe qendra për mbështetje të mësimit në vitin shkollor 2023/24.</p>	<p>dëmtim të dëgjimit, pengesa në zhvillimin mendor (paaftësi intelektuale), multihandikap dhe autizmit.</p> <p>Janë siguruar kushtet për realizimin e mësimit sipas planeve të reja mësimore për nxënësit me dëmtime në shikim, dëgjim, pengesa në zhvillimin mendor (paaftësi intelektuale), multihandikap dhe autizëm.</p>	
<p>3. Realizimi i trajnimeve me kuadrin arsimor të shkollave fillore për programet e reja mësimore dhe tema të tjera që kanë të bëjnë me procesin arsimor sipas kërkesave të Qeverisë, MPPS-së, MASH-it dhe dinamikës së reformave në arsimin fillor.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Është zhvilluar moduli për realizimin e trajnimeve për të gjithë mësime të klasës së IV (katërt) të arsimit fillor; - Është zhvilluar modul për realizimin e trajnimeve për të gjithë mësime të klasës së VI (gjashtë) të arsimit fillor; - Të trajnuar 30 trajnues këshilltarë nga BZhA-ja dhe 6 trajnues bashkëpunëtorë të jashtëm - trajnim për planifikimin dhe zbatimin e programeve të reja për klasën e VI (të gjashtë). - Të trajnuar 1.958 mësime të klasës së IV (të katërt) në vitin shkollor 2023/2024, përfshirë mësime të shkollave të ciklit të ulët që nuk 	<p>Sipas moduleve të zhvilluara, janë realizuar trajnime për mësime të klasës së IV (të katërta) dhe të VI (të gjashta) sipas programeve të reja dhe konceptit të ri për arsimin fillor.</p> <p>Trajnime për planifikimin dhe zbatimin e mësimeve sipas planprogrameve për klasën e IV (të katërt) - 1958 arsimtarë të trajnuar.</p> <p>Mësime të klasës së trajnuar e zbatojnë mësime sipas konceptit të ri për arsimin fillor dhe programeve të reja për klasën e IV (të katërt) në vitin shkollor 2023/24.</p> <p>Trajnime për planifikimin dhe realizimin e mësimit sipas programeve të reja për klasën e VI (të gjashtë) - 4877 mësime të trajnuar, nga të cilët</p>	

	<p>kanë marrë trajnime më parë, për planifikimin dhe zbatimin e mësimdhënies në përputhje me programet e reja;</p> <p>- Të trajnuar 4877 mësimdhënës lëndorë që japin mësim në klasën e VI (të gjashtë) në vitin shkollor 2023/2024 për konceptin e ri për arsimin fillor dhe për planifikimin dhe zbatimin e mësimdhënies sipas programeve të reja;</p> <p>- Është duke u zhvilluar trajnimi për edukimin mediatik për mësimdhënësit klasor dhe mësimdhënësit lëndorë që zhvillojnë mësimin e gjuhës amtare; Për këtë temë janë trajnuar 5300 mësimdhënës;</p> <p>- Të trajnuar 21 mësimdhënës nga shkollat fillore për zbatimin e mësimin të lëndës Inovacionet në klasën IX (nëntë) të arsimit fillor.</p>	<p>3831 mësimdhënës të trajnuar të cilët japin mësim në gjuhën maqedonase, gjuhën turke, gjuhën serbe, gjegjësisht gjuhën boshnjake, 1029 mësimdhënës të trajnuar të cilët japin mësim në gjuhën shqipe dhe 17 mësimdhënës të trajnuar që japin mësim në gjuhën turke.</p> <p>Mësimdhënësit lëndorë të trajnuar e zbatojnë mësimin sipas konceptit të ri për arsimin fillor dhe programeve të reja për klasën VI (të gjashtë) në vitin shkollor 2023/24.</p> <p>Mësimdhënësit e trajnuar fituan kompetenca për realizimin e fushës së Shtim-leximi mediatik dhe kultura mediatike nga programi mësimor në gjuhët amtare në mësimdhënien klasore dhe lëndore.</p> <p>Mësimdhënësit e trajnuar morën certifikatën e përfundimit të trajnimit për inovacionet dhe sipërmarrja me të cilën në përputhje me normën e kuadrit mësimor mund të ligjërojnë lëndën Inovacionet në klasën IX (nëntë) të arsimit fillor.</p>	
<p>3. Hartimi i koncepteve, akteve nënligjore, udhëzimeve dhe dokumenteve të tjera për arsimin fillor në përputhje me kërkesat e</p>	<p>- U përgatit <i>Udhëzues për planifikimin, organizimin dhe zbatimin e mësimin nga klasa e parë</i></p>	<p>Organizimi dhe realizimi i suksesshëm i mësimin nga klasa e parë deri në të gjashtë në arsimin fillor në vitin shkollor 2023/24.</p>	

Qeverisë, MPPS-së, MASH-it dhe dinamikës së zbatimit të reformave në arsimin fillor.	deri në të 6-tën në arsimin fillor në vitin shkollor 2023/24; - U përgatit Udhëzues për planifikimin, organizimin dhe zbatimin e mësimin shtues dhe plotësues nga klasa e parë deri në të 6-tën në arsimin fillor në vitin shkollor 2023/24.	Organizimi dhe realizimi me sukses i mësimin shtues dhe plotësues nga klasa e parë deri në të gjashtë në arsimin fillor në vitin shkollor 2023/24.	
--	---	--	--

MASAT DHE AKTIVITETET SHITESË TË REALIZUARA - TË PAPANIFIKUARA NË PLANIN VJETOR 2023

Masat/aktivitetet	Indikatorët e rezultateve me pikënisjen dhe rezultati i planifikuar në nivel vjetor	Vlerësimi i progresit në arritjen e rezultateve dhe qëllimeve të programit	Koment
Nuk ka			

MASAT DHE AKTIVITETET E PAREALIZUARA

Masa/aktiviteti	Arsyetimi	Ndikimi	Rekomandime
Nuk ka			

Titulli i nënprogramit 3: Standardet, planet dhe programet mësimore të arsimit të mesëm (gjimnaz, artistik, gjimnazi i sportit, akademia e sportit, arsimit të mesëm profesional, arsimit të nxënësve me nevojë të veçanta arsimore dhe gjimnazi matematikë-informatikë)	Qëllimi i nënprogramit: Përmirësimi i cilësisë në arsimin e mesëm	Përgjegjës: Sektori për zhvillimin e sistemit edukativ-arsimor dhe krijimin e standardeve, planeve dhe programeve mësimore
--	---	--

MASAT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA

Masat/aktivitetet	Indikatorët e rezultateve me pikënisjen dhe rezultati i planifikuar në nivel vjetor	Vlerësimi i progresit në arritjen e rezultateve dhe qëllimeve të programit	Koment
<p>1. Hartimi i programeve të reja mësimore në përputhje me kërkesat e Qeverisë, MASH-it dhe dinamikës së zbatimit të reformave në arsimin e mesëm.</p>	<p>- U hartuan programe mësimore nga lëndët (e detyrueshme dhe zgjedhore) për vitin IV (katërt) të gjimnazit matematikë-informatikë, të detyrueshme: Gjuhë dhe letërsi maqedonase, Gjuhë dhe letërsi shqipe, Gjuhë maqedonase për nxënësit e komuniteteve tjera, Gjuhë angleze, Fizik, Sporti dhe aktivitetet sportive, Algjebra, Gjeometria, Analiza matematikore, Programimi, Informatika dhe Baza e të dhënave, si dhe zgjedhore: Zbatimi i matematikës në shkencat natyrore, Zbatimi i matematikës në ekonomi, Probabiliteti dhe statistika, Ueb-programimi dhe Paradigmat programore;</p> <p>- U hartuan programet mësimore nga lënda Gjuhë dhe letërsi turke për vitin I, II, III dhe IV të arsimit të mesëm katërvjeçar;</p> <p>- U hartua program mësimor nga lënda Gjuhë angleze për nxënësit e vitit të V (për nxënësit me dëgjim të dëmtuar në arsimin e mesëm profesional me gjatësi pesëvjeçare;</p>	<p>Mësimi në vitin IV (katërt) në gjimnazin matematikë-informatikë zhvillohet sipas programeve të reja mësimore.</p> <p>Mësimi i lëndës Gjuhë dhe letërsi turke në vitet I, II, III dhe IV të arsimit të mesëm profesional katërvjeçar zhvillohet sipas programeve të reja mësimore.</p> <p>Mësimi i lëndës Gjuhë angleze në vitin V-të për nxënësit me dëmtime dëgjimi në arsimin e mesëm profesional me</p>	

	<p>- U hartuan programet e reja të provimeve nga lëndët e përgjithshme: Gjuhë dhe letërsi maqedonase për provimin e maturës shtetërore për gjimnazin, arsimin e mesëm artistik dhe arsimin e mesëm profesional, Gjuhë dhe letërsi shqipe për provimin e maturës shtetërore për gjimnazin, arsimin e mesëm artistik dhe arsimin e mesëm profesional, Gjuhë dhe letërsi turke për provimin e maturës shtetërore për gjimnazin, arsimin e mesëm artistik dhe arsimin e mesëm profesional, Gjuhë dhe letërsi maqedonase për provimin e maturës shkollore për gjimnazin, arsimin e mesëm artistik dhe arsimin e mesëm profesional, Gjuhë dhe letërsi shqipe për provimin e maturës shkollore për gjimnazin, arsimin e mesëm artistik dhe arsimin e mesëm profesional, Gjuhë dhe letërsi turke për provimin e maturës shkollore për gjimnazin, arsimin e mesëm artistik dhe arsimin e mesëm profesional, Gjuhë dhe letërsi maqedonase për provimin përfundimtar në arsimin e mesëm profesional, Gjuhë dhe letërsi shqipe për provimin përfundimtar në arsimin e mesëm profesional, Gjuhë dhe letërsi turke për provimin</p>	<p>kohëzgjatje pesëvjeçare zhvillohet sipas programit të ri.</p> <p>Provimi i maturës shtetërore, provimi i maturës shkollore dhe provimi përfundimtar zhvillohen në përputhje me programet e reja të provimeve për lëndët mësimore përkatëse.</p>	
--	---	--	--

	<p>përfundimtar në arsimin e mesëm profesional;</p> <p>- Përditësimi, ndryshimi dhe plotësimi i planeve mësimore të arsimit të mesëm profesional (dyvjeçar, trevjeçar, katërvjeçar dhe dual).</p>	<p>Mësimi në arsimin e mesëm profesional zhvillohet sipas planeve të reja mësimore.</p>	
<p>2. Hartimi i koncepteve, akteve nënligjore, udhëzimeve dhe dokumenteve të tjera për arsimin e mesëm në përputhje me kërkesat e Qeverisë, MASH-it dhe dinamikës së zbatimit të reformave në arsimin e mesëm.</p>	<p>- U përpilua testi në matematikë dhe testi në fizikë për provimin pranues në gjimnazin matematikë-informatikë;</p> <p>- U përpiluan dy teste për testimin kualifikues për lëndën mësimore biologji dhe lëndën mësimore kimi për regjistrimin e nxënësve në drejtimin shëndetësor të arsimit të mesëm profesional katërvjeçar në vitin shkollor 2023/2024;</p> <p>- U hartua Propozim-Ligji i ri për arsimin e mesëm.</p>	<p>U realizua provimi pranues në gjimnazin matematikë-informatikë për vitin shkollor 2023/2024.</p> <p>U realizua testimi kualifikues në lëndët biologji dhe kimi në ShMMQSH "Dr. Pançe Karagjov" – Shkup për regjistrimin e nxënësve në drejtimin shëndetësor në arsimin e mesëm profesional katërvjeçar në vitin shkollor 2023/2024.</p> <p>BZhA-ja mori pjesë në mënyrë aktive në hartimin e Ligjit të ri për arsimin e mesëm.</p>	

MASAT DHE AKTIVITETET SHITESË TË REALIZUARA - TË PAPANIFIKUARA NË PLANIN VJETOR 2023

Masat/aktivitetet	Indikatorët e rezultateve me pikënisjen dhe rezultati i planifikuar në nivel vjetor	Vlerësimi i progresit në arritjen e rezultateve dhe qëllimeve të programit	Koment
Nuk ka			

MASAT DHE AKTIVITETET E PAREALIZUARA

Masa/aktiviteti	Arsyetimi	Ndikimi	Rekomandime
-----------------	-----------	---------	-------------

1. Krijimi i standardeve kombëtare për kompetencat që duhet të kenë nxënësit në përfundim të arsimit të mesëm.	Masa nuk është zbatuar sepse duhet të miratohet Ligji i ri për arsimin e mesëm.	Vonesa në reformat e arsimit të mesëm sipas Strategjisë së Arsimit 2018-2025.	
--	---	---	--

Titulli i nënprogramit 4: Hulumtime për avancimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm	Qëllimi i nënprogramit: Analiza dhe përcaktimi i progresit në procesin edukativ-arsimor në tema të proceseve aktuale reformuese	Përgjegjës: Sektori për hulumtime në arsim
---	---	--

MASAT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA

Masat/aktivitetet	Indikatorët e rezultateve me pikënisjen dhe rezultati i planifikuar në nivel vjetor	Vlerësimi i progresit në arritjen e rezultateve dhe qëllimeve të programit	Koment
1. Analiza e teksteve, literaturës profesionale dhe revistave për fëmijë për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm.	Për të gjitha tekstet shkollore për të cilat është paraqitur kërkesë nga Shërbimi Pedagogjik, janë përpiluar mendime profesionale nga komisionet e ngritura, përkatësisht: tekste për gjuhën maqedonase, gjuhën shqipe, gjuhën turke, gjuhën serbe dhe gjuhën boshnjake për klasën e tretë dhe të gjashtë, matematikën për klasën e tretë dhe të gjashtë, shoqërinë për klasën e tretë dhe historinë dhe shoqërinë për klasën e gjashtë, shkencat natyrore për klasën e tretë dhe të gjashtë. Me kërkesë të MASH-it, në bashkëpunim me QATP-në u përgatitën mendime profesionale për dorëshkrimet e teksteve për	Në bazë të mendimit të dhënë, Shërbimi Pedagogjik, MASH miratoi tekste shkollore për lëndët e klasave të treta dhe të gjashta dhe ato përdoren në mësimdhënie nga nxënësit e klasave të treta dhe të gjashta. Mbështetur në mendimet e dhëna për dorëshkrimet për tekstet e arsimit të mesëm profesional, SHP dhe MASH-i morën vendim për miratimin e teksteve për përdorimin e tyre nga nxënësit e arsimit të mesëm.	

	<p>lëndët mësimore profesionale për arsimin profesional.</p> <p>Me kërkesë të komisionit të krijuar pranë MASH-it për miratimin e literaturës profesionale, u përpiluan mendime profesionale për të gjitha revistat, fletoret e punës si dhe literaturën profesionale për mësimdhënësit.</p>		
<p>2. Analiza e kërkesave për miratimin e projekteve dhe hulumtimeve në arsimin fillor dhe të mesëm</p>	<p>Në bazë të kërkesës së MASH-it, janë përgatitur mendimet profesionale nga këshilltarët e sektorit të hulumtimit për të gjitha projektet e paraqitura që zbatohen nga organizatat joqeveritare, institucionet etj.</p>	<p>Mendimet e përgatitura shfrytëzohen nga MASH-i për përgatitjen e përgjigjes për miratim për realizimin e projekteve në arsimin fillor apo të mesëm.</p>	
<p>3. Hulumtime të realizuara për avancimin e aspekteve të rëndësishme të arsimit fillor dhe të mesëm</p>	<p>U realizua hulumtimi për zbatimin e lëndëve të lira zgjedhore në arsimin fillor. Hulumtimi është kryer për të dhënë përgjigje në pyetjet:</p> <p>Të shihen përvojat e mësimdhënësve nga zbatimi i lëndëve të lira zgjedhore për të identifikuar nevojat, sfidat dhe përfitimet që lidhen me zbatimin e tyre.</p> <p>Të kuptohen perceptimet e mësimdhënësve në lidhje me kuptimin e lëndëve të lira zgjedhore dhe gatishmërinë e tyre për të zbatuar lëndët e lira zgjedhore</p> <p>Të kuptohen perceptimet e nxënësve për kuptimin e lëndëve të lira</p>	<p>Rekomandimet nga hulumtimi japin drejtime për përmirësimin e mësimdhënies së lëndëve të lira zgjedhore dhe paraqesin bazën për përmirësimin e udhëzimeve për organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve të lira zgjedhore dhe lëndëve të lira zgjedhore.</p>	

	<p>zgjedhore dhe përfitimin e zbatimit të tyre</p> <p>Në hulumtim janë përfshirë 119 shkolla fillore nga 56 komuna, që përfaqëson 34.7% të numrit të përgjithshëm të shkollave fillore në vend.</p> <p>Hulumtimi ka përfshirë 4783 mësimdhënës nga shkollat fillore të përfshira që japin mësim në periudhën e dytë dhe të tretë të arsimit fillor (nga klasa IV deri në IX).</p> <p>Hulumtimi përfshinte 4909 nxënës nga klasa VIII dhe një nga klasa IX nga çdo gjuhë mësimore e përfaqësuar në shkollat fillore të përfshira në mostër.</p> <p>Për të siguruar të dhëna në lidhje me objektivat e deklaruara të hulumtimit, u ndërtuan tre pyetësorë – një për nxënësit dhe dy për mësimdhënësit.</p> <p>Pyetësor i dedikuar për nxënësit Pyetësor për mësimdhënësit-zbatues Pyetësor për mësimdhënës-zbatues potencial</p> <p>Protokolli i grupit të fokusit Është përgatitur raport me rezultatet e hulumtimit dhe me konkluzionet dhe rekomandimet, të cilat do të postohen në faqen e internetit të BZhA-së.</p>		
--	--	--	--

<p>4. Realizimi i projekteve kërkimore-shkencore në fushën e AGjS-së</p>	<p>Në bashkëpunim me HERA janë mbajtur tri takime me mësimdhënës dhe prindër nga shkollat fillore nga katër komuna, përkatësisht; Kavadar, Qendër - Shkup, Gostivar për prezantimin e programit për lëndën me zgjedhje të lirë AGjS-së.</p>	<p>Sensibilizimi i popullatës së mësimdhënësve dhe prindërve për përfitimet e zbatimit të programit të AGjS-së me nxënësit e klasës së nëntë në arsimin fillor.</p>	
<p>5. Realizimi i Programit për mbrojtjen e konsumatorëve</p>	<p>1. Me rastin e 15 Marsit, Ditës Botërore të të Drejtave të Konsumatorit, u organizua dhe u realizua një konkurs artistik për fëmijët e kopshteve dhe nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme në vend, i cili shënoi të drejtat e konsumatorëve në vitin 2023 nën moton: „Fuqizimi i konsumatorëve përmes kalimit në energji të pastër". Qëllimi i konkursit artistik ishte që fëmijët dhe nxënësit të shprehin mendimin e tyre kritik në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve me theks të veçantë në ruajtjen e mjedisit jetësor, dhe rrjedhimisht planetit Tokë, përmes një krijimtarie artistike.</p> <p>Konkursi artistik u mbajt në 4 (katër) kategori: " Tema: "DIELI, ERA DHE UJI - PLANETI YNË I GJELBËR" i dedikuar për fëmijët e kopshtit të moshës 4-</p>	<p>U ndanë Certifikata dhe çmime për studentët pjesëmarrës në konkursin artistik për ruajtjen e mjedisit.</p> <p>U ndanë Certifikata mësimdhënësve dhe nxënësve të trajnuar nga 17 shkolla të mesme për rëndësinë e edukimit financiar dhe ligjeve dhe rregulloreve për mbrojtjen e konsumatorëve.</p> <p>U ndanë Certifikata për edukatorë të trajnuar dhe bashkëpunëtorë profesional nga kopshtet publike nga Shkupi për lodra për fëmijë - shëndeti dhe siguria e fëmijëve".</p>	

	<p>5/6vjeç. Në total kanë mbërritur 93 vepra arti nga 32 kopshte në vend.</p> <p>" Tema: "ENERGJIA E GJELBËR PËR NJË PLANET TË GJELBËR" e dedikuar për nxënësit nga arsimi fillor (mësimi klasor) nga klasa e parë deri në klasën e pestë. Arritën 145 vepra arti nga 58 shkolla fillore.</p> <p>" Tema: "NE JEMI GJENERATA E GJELBËR SHFRYTËZOJMË ENERGJINË E GJELBËR" e dedikuar për nxënësit e arsimit fillor (mësimi lëndor) nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë. Arritën 94 vepra arti nga 41 shkolla fillore.</p> <p>" Tema: "KONSUMATORI QËNDRUESHËM DHE ENERGJIA E GJELBËR" e dedikuar për nxënësit e shkollave të mesme, nga viti i parë deri në të katërt. Arritën 30 vepra arti nga 13 shkolla të mesme.</p> <p>Çmimet e para, të dyta dhe të treta u dhanë për secilën kategori veç e veç.</p> <p>2. Punëtori e realizuar (8-9 nëntor 2023 në Klubin e organeve të administratës në Shkup) për mësimdhënës dhe nxënës nga shkollat e mesme të Shkupit me temë „ Njohja me dispozitat e Ligjit të ri për mbrojtjen e konsumatorit”. Në kuadër të punëtorisë, e cila ishte</p>		
--	---	--	--

	<p>interaktive, mësimdhënësit dhe nxënësit nga 17 shkollat e mesme të regjistruara (17 mësimdhënës dhe 35 nxënës gjithsej) mësuan për të drejtat e konsumatorit të garantuara me ligj, për marrëdhëniet me konsumatorët, nxitjet e shitjeve, praktikat e padrejta tregtare, përmbajtjen digjitale dhe shërbimet digjitale, detyrimet e tregtarëve që ofrojnë shërbime publike, të drejtat dhe detyrimet si përdorues të shërbimeve të komunikimit dhe procedurat në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe procedurën për realizimin e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve.</p> <p>Pas përfundimit të punëtorisë, pjesëmarrësit (mësimdhënës dhe nxënës) morën certifikatë pjesëmarrjeje.</p> <p>3. Punëtori e realizuar (20.11.2023 në IPK Kopshti “Orce Nikollov”, objekti “Xvezdiçki” – Karposh 4 në Shkup) për edukatore nga kopshtet e fëmijëve nga Shkupi me temë “Lodrat për fëmijë – shëndeti dhe siguria e fëmijëve”. Në punëtori morën pjesë gjithsej 44 edukatore dhe 2 drejtore kopshtesh. Edukatorët mësuan për të drejtat e</p>		
--	---	--	--

	<p>konsumatorëve të garantuara me ligj, si dhe procedurën për realizimin e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit.. Në punëtori, theks i veçantë u vu në produktet e destinuara për fëmijë – lojtarët fëmijë, domethënë në përdorimin e lodrave në procesin edukativo-arsimor, por edhe në zgjedhjen e duhur të një lodre për fëmijë që nuk kërcënon sigurinë dhe shëndetin e fëmijëve. . Edukatorëve iu dha edhe një detyrë praktike për të krijuar lodra edukative dhe të sigurta, si dhe poster dhe një fletushkë që do të informonte prindërit/kujdestarët e fëmijëve se si të bëjnë zgjedhjen e duhur të lodrës së fëmijëve. Pas përfundimit të punëtorisë, pjesëmarrësit morën certifikatë pjesëmarrjeje.</p>		
MASAT DHE AKTIVITETET SHITESË TË REALIZUARA - TË PAPANIFIKUARA NË PLANIN VJETOR 2023			
Masat/aktivitetet	Indikatorët e rezultateve me pikënisjen dhe rezultati i planifikuar në nivel vjetor	Vlerësimi i progresit në arritjen e rezultateve dhe qëllimeve të programit	Koment
Nuk ka			
